

SONILA BOÇI

**PARTIA E PUNËS SË SHQIPËRISË NË KËRKIM
TË “ALEATËVE” NË GJIRIN E KOMUNISTËVE ITALIANË
(1961-1962)**

Ardhja e Nikita Hrushovit në krye të Bashkimit Sovjetik (BS) ridimensionoi jo vetëm botën komuniste, por edhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Fjalimi i tij sekret në Kongresin XX të PK të BRSS dhe dënimi i kultit të individit, të krijuar nga Stalini, shkaktoi tërmet në lidhshpirtin ekzistues të Lindjes Komuniste. Situata po ndryshonte duke përjetuar dinamika të fuqishme, që u demonstruan qartazi në ngjarjet e ndodhura në Poloni, Hungari apo edhe në Shqipëri me Konferencën III të Komitetit të Partisë së Punës së Shqipërisë (PPSH) së Tiranës. Në të njëjtën mënyrë, Kongresi XX i PK të BS-së hapi rrugën edhe për reagimin e komunistëve të vendeve perëndimore. Ideja e policentrizmit dhe “rrugës italiane për në socializëm”, e hedhur nga kreu i Partisë Komuniste Italiane (PKI), Palmiro Togliatti, në Kongresin VIII të saj (8 dhjetor 1957) ishte dëshmi tjetër e rëndësishme e një bote komuniste në ndryshim¹.

¹ PPSH-ja, megjithëse e ftuar, nuk dërgoi përfaqësues të saj në Kongresin VIII të PKI-së. Ajo u njoh me zhvillimet në këtë kongres dhe me tezat e Togliattit nga një sërë relacionesh, të cilat u dërguan nga ministri shqiptar në Romë, Edip Çuçi. Për më shumë për reagimin e PPSH-së mbi zhvillimet në Kongresin VIII të PKI-së, shih: Nicola Pedrazzi, *Italia che sognava Enver, partigiani, comunisti, marxisti-leninisti, gli amici italiani dell'Albania Popolare (1943-1976)*, Lecce: Salento Books, 2017, p. 228-236. Enver Hoxha reagoi ndaj tezave të Togliatti-t në mënyrë të ngjashme sikurse kishte bërë me raportin sekret të Hrushovit në Kongresin XX të PKBS. Ndonëse i gjykonte tezat e Togliattit si revizioniste, ai vendosi të tregojë i duruar për të shprehur kundërshtimin e tij. Në dosjen arkivore që mban relacionet për Kongresin VIII të PKI-së, gjendet edhe një pusullë e vogël e shkruar me dorë. Është një shënim i Enver Hoxhës për Liri Belishovën, një prej sekretareve të KQ të PPSH-së, që mban datën 4 dhjetor 1957. Ai i kërkon asaj të përgatiste një letër udhëzuese për ministrin shqiptar në Romë mbi “si e mendojmë ne në lidhje me sa parashtron dhe të vlerësojmë punën duke e këshilluar si të veprojë pas kësaj [këndeje në tekst]. Gjithashtu ta informojmë që për pikëpamjet e Togliattit të shfrytëzojë konsultën e Moskës”. Por më vonë, në të njëjtën pusullë me laps të kuq Enver Hoxha ka urdhëruar që letra të mos dërgohet. Shih: *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë*

Dinamikat në Lindjen Komuniste nxorën në sipërfaqe një konflikt të ri, atë ndërmjet PK të Kinës (PKK) dhe PK të Bashkimit Sovjetik (PKBS). Konflikti në thelb gjeostrategjik i diktuar nga nevoja e liderit kinez Mao Ce Dunit për të siguruar një vend të rëndësishëm udhëheqës për Kinën në Botën Komuniste, pas Kongresit XX të PKBS u shndërrua në një përplasje ideologjike, e cila gjatë vitit 1960 çoi në një përplasje të hapur ndërmjet këtyre dy partive. Roli i kreut të PPSH-së, Enver Hoxhës, në këtë konflikt fillimisht ishte periferik. Qartazi lëvizjet e Hrushovit, si: përpjekjet e tij për t'u afruar me Jugosllavinë; për të rehabilituar të dënuarit e pas konfliktit të Informbyrosë me Jugosllavinë e Titos; dhe, veçanërisht, platforma e Hrushovit për destalinizmin, ishin kampionë alarmi në Tiranë². Ato krijuan pasiguri te udhëheqësi komunist i Shqipërisë së vogël, por Hoxha nuk kishte as forcën dhe as mundësinë për të reaguar hapur. I frikësuar për të ardhmen e pushtetit të vet, Enver Hoxha e pa konfliktin kinezo-sovjetik si një barkë shpëtimi. Në mbledhjen e Bukureshtit (qershor 1960), në mënyrë të papritur përfaqësuesi i Shqipërisë, Hysni Kapo mbështeti delegacionit e PKK-së. Ndërsa në Mbledhjen e 81 Partive Komuniste dhe Punëtore, e mbajtur në Moskë nga 10 nëntori deri më 1 dhjetor 1960, qëndrimi i delegacionit të PPSH-së të drejtuar nga Enver Hoxha, në mbështetje të tezave të hedhura nga PKK-ja, e kapërceu për nga ashpërsia e retorikës edhe vetë delegacionin kinez³.

(më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 14 / Arkivi i Partisë (më tej: AP) "Marrëdhëniet me PKI", viti (më tej: V.) 1957, dosja (më tej: D.) 1/3, fl. 1. Shënim i Enver Hoxhës për Liri Belishovën, 4 dhjetor 1957.

² Raporti sekret i mbajtur nga Nikita Hrushov në Kongresin XX të PKBS-së, i cili dënonte kultin e individit të ngritur nga Stalini, krimet e kryera gjatë drejtimit të tij, ishte një dush me ujë të ftohtë për udhëheqësit komunistë shqiptarë. Enver Hoxha nuk reagoi menjëherë ndaj tezave të hedhura në këtë kongres. Më 2 mars 1956, ai informoi Plenumin e KQ të PPSH-së, mbi këtë fjalim. Por më parë, Hoxha u kërkoi anëtarëve të plenumit të mbyllnin blloqet e shënimeve dhe të fusnin lapsat në xhep. Kjo donte të thoshte se çështja do të mbetej brenda drejtuesve më të lartë të PPSH-së dhe anëtarësia e partisë nuk do të informohej mbi pikëpamjet e Hrushovit në Kongresin XX. Shih: Ana Lalaj, *Pranvera e rrejtshme e pesëdhjetë e gjashtës*, Tiranë: Infbotues, 2015, f. 36-37. Panoramë interesante për gjendjen që ekzistonte në gjirin e Byrosë Politike pas Kongresit XX të PK të BS na jep Spartak Ngjela, *Përkulja dhe rënia e tiranisë shqiptare, refleksione për një kohë 1957-2010*, Tiranë: UET/Press, 2011, f. 95-97.

³ Në raportin që Enver Hoxha mbajti përpara Plenumit XXI të KQ të PPSH-së, parashtrroi në thelb këto divergjencë ideologjike ndërmjet PKK-së dhe PPSH-së, nga njëra anë, dhe PKBS-së e partive të tjera komuniste e punëtore nga ana tjetër:

Qëndrimi i ashpër dhe intransigent i udhëheqësve komunistë shqiptarë gjatë dhe pas Mbledhjes së Moskës, sjellja e tyre aspak diplomatike me përfaqësuesit sovjetikë në Shqipëri e shndërroi konfliktin nga ideologjik, në diplomatik dhe shtetëror. Marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe BRSS-së u ndërpre në më 3 dhjetor 1961. Enver Hoxha dhe PPSH-ja e shkëputën veten nga tutela e Bashkimit Sovjetik duke përjetuar atë që shkrimtari shqiptar Ismail Kadare do ta përcaktonte si “Dimrin e Vetmisë së Madhe”.

Drejtimesit e lartë të PPSH-së u përpoqën të nxirrnin sa më shumë përfitime nga situata e krijuar. Në planin e brendshëm, shtypi dhe media e kontrolluar nga shteti nuk pushonin së dënuari “tradhtinë e Hrushovit” dhe “qëndrimin heroik” të mbajtur nga Enver Hoxha dhe PPSH-ja në Mbledhjen e 81 Partive Komuniste e Punëtore në Moskë. Propaganda zyrtare gjëmonte me të madhe se në këtë luftë parimore, PPSH-ja dhe Kina komuniste nuk ishin të vetmet dhe kishin mbështetjen e të gjithë komunistëve të ndershëm kudo në botë. Në sytë e shqiptarëve, tanimë, Enver Hoxha ishte udhëheqësi që për të dytën herë kishte shpëtuar pavarësinë e Shqipërisë nga synimet aneksioniste të social-imperializmit sovjetik, por kishte mbajtur të pastër dhe të paprekur ideologjinë marksiste-leniniste.

Studiuesja Hannah Arendt, në një analizë krahasuese ndërmjet totalitarizmit dhe formave të tjera të shtypjes politike, si despotizmit, tiranisë dhe diktaturave, thekson se, ajo që i dallon në mënyrë të pakundërshtueshme ato, është “përcaktimi i një politike të jashtme të drejtuar drejt dominimit të botës”⁴. Kuptohet që për drejtuesit komunistë të Tiranës, dominimi real politik dhe ushtarak i botës ishte një aventurë e parralizueshme. Por, në kushtet e krijuara në Lëvizjen Komuniste Ndërkombëtare, megalomania e Enver Hoxhës donte të shfrytëzonte situatën për t’i dhënë PPSH-së një rol drejtues. Kjo do të thoshte se ai

përcaktimi i karakterit të epokës, mbi luftën dhe paqen, mbi konceptimin e bashkekzistencës paqësore, mbi konceptin e unitetit, mbi revolucionet dhe rrugën paqësore për në socializëm etj. *AQSH*, F. 14/AP (organet udhëheqëse), V. 1960, D. 6. Raport i mbajtur nga Enver Hoxha në Plenumin e KQ XXI të PPSH, 19-20 dhjetor 1960.

⁴ Hannah Arendt, *The origins of totalitarianism*, Houghton Mifflin Harcourt, 1973, f. 460.

shpresonte që enverizmi⁵ si një derivat i marksizëm-leninizmit të ishte ideologji dominuese, të paktën për Lëvizjen Komuniste Marksiste-Leniniste në Evropë. Nuk ishin rastësi që në letërkëmbimin ndërmjet drejtuesve të lartë të KQ të PPSH-së dhe përfaqësuesve diplomatikë shqiptarë në Europë, emri PPSH vendosej përgjithësisht para atij të PKK-së.

Drejtuesit e lartë të PPSH-së ravijëzuan një strategji të mirëfilltë për të propaganduar “vijën e drejtë marksiste-leniniste të PPSH” dhe sukseset e socializmit shqiptar. Komitetit të Marrëdhënieve Kulturore dhe Miqësore me Botën e Jashtme (KMKMBJ), i cili varej në mënyrë të dyfishtë, si nga Ministria e Punëve të Jashtme, ashtu dhe nga legata e Jashtme e KQ të PPSH-së iu ngarkua të organizonte propagandimin dhe popullarizimin e Shqipërisë dhe PPSH-së në Evropë dhe në botë. Misto Treska, drejtuesi shumëvjeçar i KMKMBJ e përkufizonte kështu, çfarë duhet të kuptohej me propagandimin e Shqipërisë: “me fjalën propagandë ne kuptojmë punën që duhet të bëjmë me forma dhe mjete të ndryshme për të paraqitur në mënyrë të drejtë një realitet që ekziston dhe t’i bindim njerëzit për këtë realitet. Duke u nisur nga kjo, propaganda jonë duhet të jetë bindëse, konkrete, e shpejtë dhe luftarake. Shkurt duhet të përshkohet nga një nivel i lartë ideologjik dhe politik dhe të bëhet në forma të atilla që të prekë drejtpërdrejtë dhe sa më thellë masat, të cilave u drejtohem, sepse në llogari të fundit janë masat ato që do të mbajnë qëndrim dhe do të veprojnë pozitivisht apo negativisht ndaj një çështjeje të caktuar”⁶.

Në periudha të ndryshme të pushtetit të PPSH-së, “popullarizimit të Shqipërisë” i ishin dhënë një sërë kuptimesh. Gjatë viteve ’50, pjesë e kësaj propagande ishte dhe popullarizimi i Bashkimit Sovjetik dhe miqësisë ndërmjet dy popujve. Pas konfliktit ndërmjet PPSH-së dhe PKBS-së dhe partive të tjera të Bllokut Komunist, “popullarizimi i Shqipërisë” do të merrte tri drejtime kryesore: së pari, do të popullarizohej drejtësia e vijës politike të PPSH-së në mbrojtje të pastërtisë së marksizëm-leninizmit; së dyti, do të dënoheshin tezat revizioniste të “social-imperializmit sovjetik” dhe atyre që e mbështesnin

⁵ “Mbi enverizmin si një hybrid ideologjik ndërmjet internacionalizmit proletar dhe nacionalizmit tradicional shqiptar”, shih: Enis Sulstarova, *Ligjërimi nacionalist në Shqipëri*, Tiranë: Afërdita, 2003, f. 76-78.

⁶ Pranvera Teli (Dibra), “Diplomaci në kuadër të Luftës së Ftohtë. Komiteti i Marrëdhënieve Kulturore dhe Miqësore me Botën e Jashtme”, në *Shejzat*, 3-4, korrik-dhjetor, Shkodër: 2017, f. 231.

atë; së treti, do të propagandoheshin sukseset e Shqipërisë në rrugën e ndërtimit të socializmit; dhe, së katërti, do t'i bëhej jehonë kulturës shqiptare, zakoneve dhe traditave të popullit⁷. Siç mund të kuptohet dhe nga drejtimit që po merrte propaganda e Shqipërisë në shtete të tjera, qëllimi i saj kryesor në këtë periudhë ishte të siguronte sa më shumë miq dhe mbështetës në konfliktin që kishte filluar ndërmjet Shqipërisë së vogël dhe shtetit-lider të botës komuniste. Në këtë situatë, diplomatët shqiptarë luajtën një rol parësor, duke zhveshur shpeshherë kostumin e diplomatit për të marrë pozicionin e agjitorit politik.

PPSH përpiqet të përshtatet në një “Botë të re Komuniste”

Që në vitin 1961, kur kontradiktat në Lindjen Komuniste ende nuk ishin bërë publike për masën e gjerë të komunistëve nëpër botë, drejtuesit e lartë të PPSH-së filluan një punë intensive për të testuar terrenin në përpjekje për të gjetur mbështetës të tezave të tyre. Në këtë fushatë të përgjithshme, gjendja në PKI fitoi një vëmendje të veçantë. Kjo, jo vetëm për faktin se PKI-ja ishte partia komuniste më e madhe dhe më e vjetër në Europën Perëndimore, por edhe për shkak të kontradiktave të brendshme që po përjetonte kjo parti pas shpалosjes së tezave të Togliattit për “rrugën italiane për në socializëm”. Kishte dhe një arsye të tretë, e cila lidhej me perceptimin e gjendjes ekonomike në Itali nga ana e drejtuesve komunistë të Tiranës. Këtë perceptim më mirë se kushdo na e sjell një bashkëbisedim i ambasadorit shqiptar në Romë, Jordan Panit⁸ me kolegun e tij çek. Duke biseduar mbi gjendjen e lëvizjes komuniste

⁷ Në një seminar për përfaqësuesit e Shqipërisë në Evropë, të mbajtur në Ministrinë e Jashtme, në shtator 1964, Fadil Paçrami u mësonte diplomatëve shqiptarë se “propaganda dhe kundërpropaganda janë për jashtë shtetit synon kryesisht: të bëjë të njohur Shqipërinë në botën e jashtme. Këtu duhet të kemi konceptin e gjerë, duke filluar nga rendi ynë shoqëror, të transformimit ekonomik dhe kultural të vendit, të historia dhe kultura e lashtë, deri te kohët më të reja të bukurisë e vendit etj. etj. E meta qëndron në atë që kemi mbetur kryesisht në çështje politike. Të bëjmë të njohur politikën e jashtme të vendit tonë, luftën e Shqipërisë në fushën ndërkombëtare, luftën e partisë sonë për pastërtinë e marksizëm-leninizmit, mbështetjen pa rezervë të lëvizjen revolucionare etj. Kjo bëhet e dobët, pse mjetet tona janë të pakta. Por edhe ato që kemi nuk i përdorim mirë”. *AQSH*, F. 14/AP str, V. 1964, D. 590. Teza mbi propagandën dhe kundërpropagandën, të përgatitura nga Fadil Paçrami, për seminarin e Ministrisë së Punëve të Jashtme me funksionarë të përfaqësive, shtator 1964.

⁸ Jordan Panit shërbeu si ambasadori shqiptar në Romë në vitet 1961-1967. Ai zëvendësoi në këtë detyrë Koço Priftin (1958-1961).

ambasadori çek kishte përmendur vështirësitë me të cilat ndesheshin komunistët e SHBA-së, të cilët për shkak të standardit të lartë të jetesës në vendin e tyre nuk mund të nxisnin popullin për revolucion. Jordan Pani i ishte përgjigjur se në perceptimin e tij gjendja ekonomike në Itali ishte shumë e favorshme që PKI të angazhohej në një revolucion proletar. Sipas diplomatit shqiptar në Itali niveli i jetesës ishte shumë i ulët, kishte papunësi të madhe, bujqësia ishte para krizës dhe politika qeveritare po pësonte dështime të njëpasnjëshme, aq sa konservatorët ishin të detyruar të bënin aleancë me socialistët për të mundur mbajtjen e pushtetit. Pani mbante qëndrim mjaft kritik ndaj PKI-së e cila, në një situatë kaq të favorshme, nuk po merrte asnjë aksion konkret. Përkundrazi “klasa punëtore dhe masat e tjera nuk përgatiten për luftë, janë lënë pa udhëheqje, po çarmatosen ideologjikisht me parlamentarizmin në vend të armatosen [me ide revolucionare - S.B.]”⁹.

Puna e vështirë për të propaganduar komunizmin, ashtu siç e shihte atë Tirana, iu ngarkua përfaqësuesve diplomatikë që ndodheshin në Romë. Ata kishin detyrë të kujdeseshin që pikëpamjet e PKK-së dhe PPSH-së, të botuara në broshura, të shpërndareshin për të gjithë “miqtë e Shqipërisë”. Në këtë fushatë u konsiderua e domosdoshme vendosja e sa më shumë kontakteve me komunistë dhe njerëz të thjeshtë në Itali, pra “zhvillimi i punës në terren”, siç e quanin drejtuesit e lartë komunistë. Kjo fushatë filloi që në muajt e parë të vitit 1961, kur marrëdhëniet mes PPSH dhe PKI ende ruanin njëllor kordialiteti e normaliteti dhe divergjencat nuk kishin filluar të artikuloreshin hapur, për më tepër edhe marrëdhëniet shtetërore mes Tiranës dhe Moskës nuk ishin ndërprerë.

Gjatë muajit mars 1961, ministri shqiptar në Romë, Koço Prifti zhvilloi një sërë vizitash në krahinat e Lombardisë dhe Emilias, me qëllim, sipas tij, për “njohje, kontaktesh, bisedash etj., që na interesojnë për punën tonë politike me bazën¹⁰”. Nuk ishte rastësi zgjedhja e këtyre krahinave për të zhvilluar këtë tur. Diplomati shqiptar e dinte se PKI kishte mbështetje të madhe në këto zona, gjë që reflektonte qartazi në fitoret e vazhdueshme të komunistëve italianë në zgjedhjet lokale. Ministri shqiptar përpiloi një informacion të detajuar mbi këtë vizitë, të

⁹ *AQSH*, F. 14/AP (str.), V. 1962, D. 566, fl. 1. Relacion takimi i zhvilluar mes Jordan Panit dhe ambasadorit çek në Romë, 8 janar 1962.

¹⁰ *Po aty*, F. 14/AP (str.), V. 1961, D. 523, fl. 1. Informacion i legatës shqiptare në Romë për KQ të PPSH, mbi vizitën e zhvilluar nga Koço Prifti në krahinat veriore të Italisë, 2 prill 1961.

cilin ia dërgoi KQ të PPSH-së. Ai shprehej i kënaqur për pritjen që i ishte bërë në këto krahina. Ai kishte vizituar fabrika, shkolla, spitale kishte takuar njerëz, madje në Modena ishte ftuar nga kryetari i bashkisë për të marrë pjesë dhe në Konferencën Solemne të zhvilluar me rastin e 100-vjetorit të bashkimit të Italisë. Sa i takon qëllimit kryesor të vizitës së tij, pra propagandimit të PPSH ndër komunistët italianë nga informacioni i ministrit Prifti mund të nxjerrim disa përfundime. *Së pari*, Prifti mendonte se Shqipëria njihet dhe vlerësohet më së shumti nga komunistët italianë të cilët kishin pasur kontakte qoftë personale, qoftë nëpërmjet literaturës me vendin e vogël ballkanik. “Miqtë që kanë qenë në Shqipëri, - shprehet Prifti, - si dhe ata që marrin materialet dhe botimet tona flasin me dashuri dhe simpati për vendin tonë, për zhvillimin dhe përparimet që kanë parë dhe lexuar, dhe këto i bëjnë të njohura dhe flasin me persona të njohur në raste të ndryshme”¹¹; *së dyti*, masa më e madhe e anëtarësisë së PKI nuk e njihnin Shqipërinë dhe dinin shumë pak mbi PPSH dhe veprimtarinë e saj. Për ata që ishin në dijeni, qëndrimi i PPSH kishte shkaktuar ndjenja që shkonin nga indiferentizmi deri në mbështetje të hapur. “Persona të tjerë sidomos fshatarë, punëtorë ose komunistë të thjeshtë me të cilët bisedova, këta dinin shumë pak gjëra mbi Shqipërinë dhe kur ju flisja unë për vendin, partinë, ndërtimin e socializmit etj., ata dëgjonin me shumë vëmendje, pyesnin dhe interesoheshin të dinin më shumë”; *së treti*, qëndrimi i PPSH në mbledhjen e Moskës dhe “lufta” e saj në mbrojtje të marksizëm-leninizmit nuk kishte pasur ndonjë jehonë të ndjeshme në Itali. “ ... Lidhur me materialet e Kongresit tonë”¹² ishin të paktë ata që kishin dijeni vetëm ata që ju dërgojnë buletinin ose materiale të tjera, ndërsa të tjerët që biseduam nuk kishin asnjë dijeni”. Ministri Prifti vërente se ata që shprehnin mbështetjen për punimet dhe vendimet e Kongresit IV të PPSH ishin komunistët e thjeshtë italianë, ose ata që kishin përgjegjësi të vogla, ndërsa drejtuesit nuk artikulonin ndonjë opinion. “Shoku Korasovi [drejtuesi lokal i PKI në Regio Emilia] p.sh., - shkruante Prifti, - nuk shprehu asnjë fjalë për mirë ose për keq, kurse i biri i tij tha: ‘i lexova me vëmendje buletinet me materialet e Kongresit, Partija juaj është në rrugë të drejtë, rezolucioni tuaj i ka me vend ato që ngren për imperializmin,

¹¹ *Po aty*, fl. 1-3. Informacion i legatës shqiptare në Romë për KQ të PPSH, mbi vizitën e zhvilluar nga Koço Prifti në krahinat veriore të Italisë, 2 prill 1961.

¹² Është fjala për Kongresin IV të PPSH, të zhvilluar në nëntor 1961, në të cilin u diskutua hapur qëndrimi i PPSH ndaj ndryshimeve në botën komuniste.

revizionizmin etj. Kur bisedonja dhe flisja për Kongresin, për jetën dhe punën e Partisë sonë me komunista që njohëm (dhe nuk marrin materiale nga ne si buletin etj.), këta tregonin një interesim të dukshëm dhe ndiqnin me vërejtje shenjat dhe shpjegimet e mija, pyesnin për realizimet ekonomike, sigurimet shoqërore, si po e ndërtojmë socializmin etj.¹³”

Ministri shqiptar perceptonte se pjesa më e madhe e komunistëve italianë po përjetonin një gjendje konfuziteti në përballje me situatën në Lëvizjen Komuniste e Punëtore në botë, por dhe me ndryshimet brenda PKI. “Materialet e konferencës së Moskës të 81 partive në përgjithësi nuk njihen nga masa e thjeshtë e partisë e punëtorëve, nuk janë punuar nëpër organizatat bazë”. Një numër i vogël i komunistëve italianë kishin mundur ta lexojnë në gazetën “Unita”, organ i KQ të PKI një shkrim të shkurtër mbi konfliktin në mbledhjen e Moskës, por, sipas diplomatit shqiptar, artikulli ishte i pamjaftueshëm dhe shumica e komunistëve ‘nuk dijnë ç’të bëjnë, si ta zbatojnë dhe kjo është natyrisht për shkak të mungesës së orientimit dhe të zbatimit të “vijës italiane për në socializëm” që ndjek partia këtu¹⁴’. Ai njoftonte eprorët e tij se kishte diferenca ndërmjet bazës së Partisë dhe drejtuesve të saj. Këta të fundit ose ishin hezitues për të folur dhe për t’u shprehur mbi ndryshimet brenda PKI, ose i mbështesnin ato. Ndërkohë, baza e Partisë nuk ishte dakord me rrugën paqësore që propozonte PKI dhe Togliatti për marrjen e pushtetit. Një pjesë e njerëzve që kishte takuar ministri Prifti, e shihnin të pamundur marrjen e pushtetit me rrugë paqësore. Relacioni i ministrit Prifti përmendte bisedën që kishte zhvilluar me një komunist në moshë të re nga Regio Emilia. Sipas të riut komunist, rasti i kësaj krahine ishte shembulli më i mirë se përse rruga parlamentare nuk do të mund të siguronte marrjen e pushtetit. Regio Emilia mbiquhej “Moska e vogël”, për shkak të suksesit të vazhdueshëm të PKI-së në zgjedhje qofshin lokale, qofshin të përgjithshme. Pavarësisht kësaj, “pushteti është në duart e kapitalistëve dhe nuk e lëshojnë ata pa ua marrë me forcë”. Ai i solli në mendje ministrit shqiptar rastin e një greve që komunistët e krahinës kishin zhvilluar para një viti, në të cilën organet e policisë kishin ndërhyrë me armë duke vrarë disa protestues. Kjo gjë e bënte të riun komunist të arrinte në përfundimin se “në greva dhe demonstrata hidhemi

¹³ *Po aty*.

¹⁴ *Po aty*, fl. 1-2. Informacion i legatës shqiptare në Romë për KQ të PPSH, mbi vizitën e zhvilluar nga Koço Prifti në krahinat veriore të Italisë, 2 prill 1961.

dhe armiku na shtie dhe na vret dhe jo pastaj të lëshojë pushtetin dhe me rrugë paqësore ta marrim ne, prandaj duhet me kryengritje dhe armë që ta marrim pushtetin, por kjo nuk përmendet dhe nuk flitet nga shokët tanë”¹⁵.

Në përfundim të raportimit të tij, Koço Prifti kishte arritur në konkluzionin se shumica e komunistëve italianë mendonte ndryshe nga udhëheqësit, por nuk shfaqnin hapur mendimet e tyre. Pavarësisht kësaj, ministri vërente se duhej bërë më shumë për propagandimin e PPSH dhe Shqipërisë në gjirin e komunistëve italianë. Ky ishte një sinjal i mirë për drejtuesit e PPSH-së për të vazhduar punën me këta komunistë të pakënaqur, me shpresën se do t’i bënin ithtarë të pikëpamjeve të tyre.

PPSH në përpjekje për të shfrytëzuar pakënaqësitë brenda PKI

Gjatë vitit 1962, situata u bë edhe më e nderë ndërmjet dy partive. Ndërprerja e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe BRSS e bëri publik konfliktin për një masë të gjerë të komunistëve italianë. Fakti që PKK ende nuk ishte shprehur publikisht për konfliktin e saj me PK të BS, te masa e gjerë e komunistëve italianë krijonte përshtypjen se mosmarrëveshjet ishin vetëm shqiptaro-sovjetike, gjë që nuk ishte pozitive për PPSH. Në janar të vitit 1962, Enver Hoxha u njoftua se fjalimi që anëtari i KQ të PKI, Luigi Longo kishte mbajtur në Mbledhjen e Moskës (1960), ishte bërë publik¹⁶. Një veprim i tillë në sytë e Hoxhës ishte një akt i dëshpëruar i PKI. Në ditarin e tij, ai shkroi: “Këtë e bëri, megjithëse e di që nuk duhet botuar, pse situatat i ka të vështira [kupto: brenda partisë së tij] dhe po i bëhen akoma më të vështira në lidhje me mosmarrëveshjet ideologjike me ne dhe me kinezët. Ajo e bën gjithashtu këtë që të provokojë kinezët dhe t’i nxisë dhe këta që të kundërshtojë

¹⁵ *Po aty*.

¹⁶ Sipas një bisede që kishte zhvilluar Sotir Vangjeli, sekretar i legatës shqiptare në Romë, me Maurizio Papparazzo-n, përgjegjës i zyrës së ligjeve në Parlamentin Italian, fjalimi i Logos kishte qarkulluar vetëm si broshurë për përdorim të brendshëm te drejtuesit e PKI-së dhe jo për të gjithë anëtarësinë. Shih: *AQSH*, F. 14/AP str., V. 1961, D. 562, fl. 14. “Relacion i Legatës shqiptare në Romë për takimin e Sotir Vangjelit dhe Sazan Nurit me Maurizio Papparazzo dhe Sante Perilli-n”.

bishtërat e Hrushovit dhe ky pastaj të luajë rolin e “arbitrit olimpik”¹⁷. Publikimi nga ana e PKI i divergjencave ideologjike që kishin përfshirë botën komuniste, si dhe përgatitjet për Kongresin X të saj shtuan urgjencën e PPSH-së për të kërkuar mënyrën që t’i bënin komunistët italianë të dëgjonin edhe anën tjetër të medaljes. Të bindur se ishin mbrojtësit e vërtetë dhe të vetëm të marksizëm-leninizmit, drejtuesit komunistë shqiptarë organizuan fushatën për të gjetur mbështetës në radhët e komunistëve italianë.

Në fokus të interesit të drejtuesve të lartë të PPSH-së, ishin komunistët italianë të cilët kishin dëshmuar se nuk e përkrahnin vijën italiane për në socializëm, veçanërisht ata që kundërshtonin heqjen dorë nga zhvillimi i “revolucionit proletar” në Itali. Sipas informacioneve që kishin zyrtarët e legatës shqiptare në Romë, më të pakënaqurit brenda radhëve të komunistëve italianë ishin “të vjetrit”, ata që kishin zhvilluar rezistencën gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kishte sinjale se ky grupim simpatizonte qëndrimin e Partisë së vogël shqiptare në konfliktin e saj me Bashkimin e madh Sovjetik. Gjatë Kongresit të Shoqatës Kombëtare të Partizanëve të Italisë (Associazione Nazionale Partigiani d'Italia (ANPI), presidenti i shoqatës, socialisti Arrigo Boldrini, në fjalën e tij përshëndetëse e kishte përmendur disa herë rezistencën shqiptare kundër nazifashizmit. Ndërsa në takime private ai u ishte deklaruar diplomatëve shqiptarë, që merrnin pjesë në kongres se: “Pavarësisht nga mosmarrëveshjet që mund të ekzistojnë midis partive tona, të cilat me kalimin e kohës do të zgjidhen sepse fjalët i merr era, ANPI dhe në ardhmen do të mbajë marrëdhënie të mira me Shqipërinë. Fakti që juve jeni këtu i ftuar e vërteton këtë. Neve nuk ju kemi ndarë nga shokët e tjerë”¹⁸. Diplomatët Sazan Nuri dhe Skënder Xhiku që po ndiqnin punimet e kongresit shpreheshin me entuziazëm për “simpatinë dhe admirimin që pjesëmarrësit në të shprehnin për partinë dhe popullin tonë”. Në Sienë ata takuan për herë të parë dhe Alberto Bargagna, një ish-komandant i dëgjuar partizan dhe njeriu që së bashku me Fosco Dinuccin do të krijonin PKI (m-1), e cila do të mbështetej nga PPSH-ja. Bargagna

¹⁷ Enver Hoxha, *Ditar për çështje ndërkombëtare (1961-1963)*, Tiranë: 8 Nëntori, 1982, f. 258. “Manovra dhe provokacione të revizionistëve italianë dhe francezë, e premtë, 26 janar 1962”.

¹⁸ *AQSH*, F. 14/AP (str.), V. 1962, D. 564, fl. 1. Informacion i ambasadorit shqiptar në Romë, Jordan Panit, për MPJ dhe për Drejtorinë e Jashtme të KQ të PPSH, mbi Kongresin e partizanëve të Sienës, 15 gusht 1962.

kishte bërë titur fort në këtë takim: “Përsëritet Shqipërisë, unë jam me ju, kurajo dhe suksese akoma më të mëdha”¹⁹.

Kjo ishte arsyeja që ish-partizanët, veçanërisht ata që kishin luftuar në Shqipëri, si: D’Angelo (ish-komisar i batalionit Gramsci), Bonaventura, Bianchi, Foschi, Calabro etj., të ishin në qendër të vëmendjes së tyre²⁰. Me rastin e festimeve të Vitit të Ri 1961, legata shqiptare në Romë, i ftoi të gjithë partizanët që kishin luftuar në Shqipëri dhe që banonin në kryeqytet për një darkë festive. Ftesës iu përgjigjën vetëm katër prej tyre. Të gjithë të ftuarve u ishte dhënë që më parë për të lexuar fjalimin e Enver Hoxhës, të mbajtur me rastin e 20-vjetorit të themelimit të PPSH-së, të cilin ata nga ana e tyre e kishin shpërndarë ndër miq të tjerë. Nga ish-partizanët që morën pjesë në darkën e legatës, D’Angelo dhe A. Calabro²¹ ishin ata që treguan mbështetje për PPSH.

Për të kuptuar strategjinë e PPSH-së në punën me komunistët italianë dhe veçanërisht qëllimet e tyre është interesante të veçohet bashkëbisedimi i zhvilluar ndërmjet D’Angelos dhe ministrit Pani. D’Angelo ishte shprehur se kishte vendosur, në shenjë proteste “të vete të dorëzohet taseren në KQ dhe të dal nga partia, por tha kërkoi këshillën tuaj”²². Ministri ishte përgjigjur se ky veprim ishte gjëja më e lehtë që

¹⁹ *Po aty*, fl. 4. Informacion i ambasadorit shqiptar në Romë, Jordan Panit, për MPJ dhe për Drejtorinë e Jashtme të KQ të PPSH, mbi Kongresin e partizanëve të Sienës, 15 gusht 1962.

²⁰ Edhe më herët italianët që kishin qenë pjesë e formacioneve partizane shqiptare kishin pasur vëmendje të veçantë nga PPSH-ja, por në këtë periudhë kujdesi u përqendrua për të kuptuar nëse këta mund të ishin pjesë e një opozicioni karshi vijës së re politike të PKI-së.

²¹ Antonio Calabro kishte qenë një nga ushtarët italianë, i cili i ishte bashkuar rezistencës shqiptare. Ai kishte luftuar në brigadën I dhe III. Gjatë luftës kishte njohur personalisht Mehmet Shehun, si dhe kishte takuar Enver Hoxhën. Ishte nga italianët e parë të riatdhesuar për në Itali, që më 1945. Ishte 52 vjeç, i paarsimuar. Në informacionin që Komiteti për Marrëdhëniet Miqësore dhe Kulturore me Jashtë ia dërgonte KQ të PPSH-së thuhej se Calabro “Në Itali ka punuar për propagandimin e Shqipërisë. Është mik i sinqertë i popullit shqiptar. I do shumë udhëheqësit dhe partinë tonë. Është aktivist i mirë dhe është mbajtur afër nga shokët e Legatës sonë në Itali. Shih: *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: AMPJ), viti (më tej: V.) 1961, dosja (më tej: D.) Komiteti 1960-1970. Informacion për qëndrimin në Shqipëri të italianit Antonio Calabro, viti 1961; *AQSH*, F. 14/AP str., V. 1961, D. 592, fl. 22-25. Informacion për qëndrimin në Shqipëri të italianit Antonio Calabro, pa datë dokumenti, por ka një shënim të Misto Treskës, “u pa”, dt. 10 dhjetor 1961.

²² *AQSH*, F. 14/AP str., V. 1961, D. 562, fl. 4. Relacion i përfaqësuesit të Shqipërisë në Romë mbi takimin me partizanët, 29 dhjetor 1961.

mund të ndërmerret “Por kush do të të kuptojë? Duhet punuar me komunistët brenda radhëve të partisë, - porosiste ministri, - me gjet ata që janë komunistë të vërtetë revolucionarë, me gjet kuadrot e veta, qofshin këta nga seksionet në provinca ose ndonjë dhe në qendër dhe të përtërihet partia jo si thonë revizionistët për së prapi, por e shpëtuar nga revizionizmi dhe këtu numri s’ka rëndësi, por vija e drejtë që tërheq me vehte masat”²³. Siç shihet nga ky bashkëbisedim, deri në këtë moment, udhëzimet e qendrës për diplomatët shqiptarë nuk ishin për të krijuar parti tjetër komuniste, por për të siguruar mbështetje të mjaftueshme brenda PKI, në mënyrë që komunistët revolucionarë të merrnin frenat e saj.

Për legatën shqiptare në Romë viti 1962 u shoqërua me një punë intensive për të takuar sa më shumë komunistë italianë, të cilëve u sqaroheshin qëndrimi i PPSH-së gjatë Mbledhjes së Moskës; u shpjegoheshin arsyet e ndërprerjes së marrëdhënieve diplomatike me BRSS-në; u “jepeshin fakte” për revizionizmin e Hrushovit dhe udhëheqësve të tjerë të Lindjes Komuniste; u propagandohej edhe kundër revizionizmit të Togliattit, i cili kishte braktisur tërësisht rrugën revolucionare për marrjen e pushtetit e kishte përqafuar parlamentarizmin. Atyre që nuk e kishin vizituar asnjëherë Shqipërinë u flitej për “sukseset që kishte arritur Shqipëria për ndërtimin e socializmit”. Nga ata diplomatët shqiptarë përpiqeshin të kuptonin se si ishte situata në radhët e PKI-së, si ishte reagimi i anëtarësisë ndaj tezave për Kongresin X të saj, mendimet e tyre për Kinën dhe Shqipërinë. Të gjitha informacionet e marra nga takimet e shumta Legata shqiptare në Romë i përmblodhi në një raport të gjatë, të cilin ia dërgoi KQ të PPSH-së më 12 qershor 1962.

Diplomatët shqiptarë nuk kishin mundur të depërtonin në radhët e udhëheqjes të PKI-së, apo te komunistë me influencë. Informacioni vinte kryesisht nga anëtarë të thjeshtë partie, pra, si i tillë dhe vërtetësia e tij ishte e dyshimtë. Gjithsesi, ai është interesant për të kuptuar si e shihte udhëheqja shqiptare atë çfarë po ndodhte brenda PKI-së dhe se si PPSH-ja ravijëzoi strategjinë e saj për të mbështetur lëvizjen revolucionare marksiste-leniniste në Itali.

Informacioni i përgatitur nga legata shqiptare në Romë për KQ të PPSH-së, nuk ndryshonte nga strukturimi me raportet që rëndom komitetet e partive të rretheve i dërgonin drejtuesve të lartë partiakë. Në

²³ *Po aty.*

sytë e komunistëve shqiptarë, që përfaqësonin Shqipërinë në Romë situata në PKI që pas Kongresit VIII ishte përkeqësuar ndjeshëm. Strukturat ishin të çorganizuara. Ato “nuk janë vetëvepruese as kanë ndonjë rol, as ngarkohen me ndonjë punë. Kjo është shumë e kuartë sepse për vetë rrugën paqësore elektorale që ka zgjedhur udhëheqja revizioniste italiane nuk i ngel asnjë punë të bëjnë komunistët e thjeshtë veç të votojnë në zgjedhjet. Për më tepër të shumtë janë ata që e fshehin anëtarësinë në parti për frikë të persekutimeve që mund të bëhen në vendin e punës²⁴”. Për shkak të kësaj situatë organizative dhe paqartësisë ideologjike, pesha që PKI kishte pasur në shoqërinë italiane po binte ditaditës. Notat negative me të cilat përshkruhej pozicioni i PKI në politikën italiane, nuk mbështetej nga faktet dhe shifrat. PKI, jo vetëm nuk kishte humbje në numrin e votuesve të saj, por përkundrazi kishte mundur të siguronte një rritje të qëndrueshme të mbështetësve në të gjithë Italinë. Ndërsa në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 1958, PKI siguroi 6.7 milion vota, më 1963 numri i votuesve të saj arriti në 7.7 milion vetë. Diplomatët shqiptarë, të mësuar me strukturimin leninist të partisë, nuk mund të ishin dakord me frymën e re që sekretari i KQ të PKI, Enrico Berlingueri kishte parashtruar në Plenumin e KQ të PKI, duke theksuar rëndësinë e ripërtëritjes së partisë “për ta zhvilluar në një mënyrë moderne duke likuiduar karakterin primitiv, spontan dhe mitik që ruan akoma”. E vetmja gjë pozitive që diplomatët shqiptarë mund të artikulonin për organizimin e PKI-së ishte kujdesi që tregohet për të rinjtë komunistë, me të cilët sipas tyre “ishte bërë një farë pune”. Është interesant standardi që përdornin diplomatët shqiptarë në Itali për të vlerësuar rininë italiane. Për ta, rinia italiane ishte individualiste dhe rendte pas gjërave materiale. Për më tepër, “... mënyra e jetesës amerikane, në art, muzikë, zakone ka penetruar veçanërisht në rininë”.²⁵

“Mëkatet” më të mëdha të PKI-së, sipas relacionit të përgatitur nga Jordan Pani, ishin ndryshimet në përbërjen e partisë, problematikat në gjendjen ideologjike të saj. Militantët e mesëm me qëndrime revolucionare, të cilët kishin qenë pjesë e rezistencës antifashiste ishin larguar nga partia. Drejtuesit e PKI-së kishin shkatërruar karakterin e partisë, si një parti e klasës punëtore, duke e shndërruar atë në një parti

²⁴ *Po aty*, F. 14/AP (str.), V. 1962, D. 559, fl. 4. Informacion i legatës shqiptare në Romë mbi gjendjen e PKI, 12 qershor 1962.

²⁵ *Po aty*.

intelektualësh. Ky ndryshim në përbërjen e partisë, ishte derivat i drejtpërdrejtë i revizionizmit të vijës politike të saj, së cilës, që kur “filloi të anojë më shumë në punën e saj elektorale demokratike, paqësore, revizioniste i duheshin njerëz për shtypin, konferenca etj., që kishin një farë përgatitje kulturele dhe të përshtatshëm për rrugën oportuniste reformiste. Kështu elementët intelektualë mikroborgjez u shtuan sidomos në aparatet dhe kjo lëkundje e partisë forcoi krahun revizionist²⁶”. Përbërja sociale e PKI-së krijonte kushte që PPSH-ja të zhvillonte “punë edukuese” brenda radhëve të saj, pasi “elementi më i shëndoshë punëtor e fshatar vuan dhe shikon boshllëkun dhe llafazanllëkun që ka bërë vend në parti, [është] kjo pjesë që reziston dhe nuk bindet për rrugën italiane të socializmit, por në mënyrën se si është ndërtuar PKI dhe si funksionon, kjo pjesë nuk peshon”²⁷.

Sa i takonte gjendjes ideologjike të PKI-së, relacioni konstatonte se drejtuesit e lartë të saj, asnjëherë nuk kishin pasur besim në fitoren e revolucionit në Itali dhe nuk e kishin përgatitur partinë për rrugën revolucionare. Një dëshmi për këtë, sipas diplomatëve shqiptarë, ishin marrëdhëniet jo fort të afërta dhe jo miqësore që PKI kishte mbajtur me PPSH. “Togliatti, vë në dukje Pani, dhe para Kongresit XX asnjëherë nuk erdhi ke ne [kupto: në Shqipëri (?!)] dhe asnjëherë s’foli mirë [për Shqipërinë] megjithëse neve me BS ishim nga më të afërtit [?!]. ... Për të diskredituar rrugën revolucionare, për të minuar pikëpamjet marksist-leniniste nuk u kursye, njëlloj si Hrushovi për të folur pa pushuar për [kupto: kundër] Stalinit ‘gabimet e tij kriminale’ etj. Nuk u kursye për të folur për BS si vend i futur në një rrugë të gabuar ku ka munguar demokracia, ligjshmëria aq sa rrezik të nxjerrin gabim që u bë revolucioni socialist në BS etj., dhe këto janë propaganduar në kor me reaksionin”²⁸. Kjo vijë politike që kishte ndjekur PKI, sipas diplomatit shqiptar, kishte minuar mundësinë e elementit revolucionar në parti që të mbronte marksizëm-leninizmin nga sulmi revizionist i Togliattit.

²⁶ *Po aty*, fl. 7. Informacion i legatës shqiptare në Romë mbi gjendjen e PKI, 12 qershor 1962.

²⁷ *Po aty*.

²⁸ *Po aty*, fl. 8-9. Informacion i legatës shqiptare në Romë mbi gjendjen e PKI, 12 qershor 1962.

Lindja e grupeve marksiste-leniniste në Itali dhe qëndrimi i PPSH ndaj tyre

Ndërsa legata shqiptare në Romë vijonte takimet për të bindur komunistët italianë për rrugën e drejtë marksiste-leniniste të PPSH-së dhe PKK-së, si dhe bëheshin sondazhe për të kuptuar nëse kishte mundësi për organizimin e një lëvizjeje revolucionare, e cila të mbështetej në dogmatikën marksiste-leniniste, brenda lëvizjes komuniste italiane filluan të ndodhnin ndryshime. Në qytete të shumta të Italisë, komunistët italianë të pakënaqur, shpeshherë të lënë dhe jashtë radhëve të PKI-së, kishin filluar të organizonin të parat grupe marksiste-leniniste, të cilat, sipas studiuesit Nicola Petrazzi, “shpejt do të mbinin si kërpudhat pas shiut në të gjithë Italinë”²⁹. Në adresë të KQ të PPSH-së, apo Komitetit për Marrëdhënie Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme, apo Drejtorisë së Punëve të Jashtme të KQ të PPSH-së, shpesh vinin letra dhe njoftime për grupe të ndryshme komunistësh italianë, apo edhe njerëz të zakonshëm. Këto letra shprehnin pakënaqësinë e tyre për zhvillimet në lëvizjen komuniste në Itali, tregonin mbështetjen për PKK-në dhe PPSH-në në konfliktin e saj me PKBS. Sipas rastit ato kërkonin mbështetjen dhe drejtimin e PPSH-së dhe të Kinës Popullore për vijimin e mëtejshëm të punës së tyre.

Ndër letrat e shumta, të dërguara legatës shqiptare në Romë dhe KQ të PPSH-së në Tiranë, veçojmë dy prej tyre, të cilat e dëshmojnë më mirë tipologjinë e letrave që i vinin udhëheqjes shqiptare. E para mban datën 3 mars 1962 dhe është shkruar nga një grup të rinjsh, të cilët jo të gjithë kishin qenë anëtarë të PKI-së. Ata kishin krijuar shoqatën, të cilën sipas tyre, e kanë pagëzuar me emrin e “mësuesit tonë të madh ‘Karl Marks’”. Kërkesa e tyre ishte propagandimi i sukseseve të Shqipërisë socialiste dhe për këtë kërkonin ndihmën e Komitetit për Marrëdhënie Miqësore dhe Kulturore me Botën e Jashtme. Në letrën e tyre, ata shkruajnë se shpirti revolucionar vazhdon të jetë i gjallë në Itali dhe se, falë punës së vazhdueshme që shoqata ka zhvilluar, numri i anëtarëve të saj kishte arritur në 250 vetë, kryesisht të rinj të vendosur për të mbrojtur ideologjinë marksiste-leniniste. Ata shprehen se ishin në dijeni të mosmarrëveshjeve që kishin lindur ndërmjet PKBS dhe PPSH. Anëtarët e shoqatës ishin të pakënaqur me qëndrimin e Hrushovit, i cili duke

²⁹ Shih: N. Pedrazzi, *Italia che sognava Enver ...*, pp. 342-370.

sulmuar publikisht PPSH, kishte kryer një akt të pastër antimarksist. “Ne besojmë, - shkruhet në letër, - se mosmarrëveshjet që lindin ndërmjet partive motra duhet të zgjidhen me durim në frymën e internacionalizmit proletar dhe mbi bazën e principeve të barazisë, prandaj kemi besim se populli shqiptar do të dijë të fitojë mbi këto sulme dhe të marshojë i sigurt për çështjen e socializmit dhe komunizmit, sepse ju nuk jeni të vetëm në luftë për këtë çështje, por keni në krahun tuaj të gjithë komunistët e botës³⁰.”

Gaetano Milaza, kreu i këtij grupimi dhe nënshkruesi i letrës, në emër të shoqatës kërkonte ndihmë në qëllimin kryesor të saj, pra propagandimit të arritjeve të Shqipërisë në ndërtimin e socializmit. Ata kishin vendosur të organizonin një ekspozitë fotografike mbi vendet socialiste, në mënyrë që t’u jepnin dëshmi dhe dokumente anëtarëve të shoqatës “për zhvillimin e arritur nga këto vende në të gjitha fushat e jetës”. Për këtë ata kërkonin që t’i dërgohej material fotografik dhe propagandistik mbi Shqipërinë³¹.

Letra tjetër është nënshkruar nga Alberto Bucco, njëri prej të përjashtuarve nga PKI, ish-drejtues i Federatës së Padovës, federatë e cila u bë pikënisje e të gjithë lëvizjes marksiste-leniniste në Itali. Kjo është letra, e cila vendosi kontaktet e para të legatës shqiptare në Romë e, më pas dhe të drejtuesve të lartë të PPSH-së me “grupin e Padovës”. Letra i vë në dijeni drejtuesit e lartë komunistë për përjashtimin nga PKI të tre prej drejtuesve të Federatës së Padovës: Vincenzo Caló, zëvendëssekretarin rajonal të Venetos, Salvatore Pellegrino, sekretarin e Federatës të PKI në Padova dhe Laretta Dirigato, anëtare e Komitetit Federativ të Federatës së PKI për Padovën. Sipas letrës tre komunistët e përjashtuar kanë qenë objekt i një fushate akuzash dhe gënjeshtresh nga ana e drejtuesve më të lartë të PKI, ndërkohë që “faji” i tyre i vetëm ishte “se duan të mbajnë lart flamurin e leninizmit”, ndërkohë që drejtuesit e PKI i sulmonin “me shpresën e gënjeshtër për t’i shkëputur ata që vijojnë luftën politike kundër revizionizmit të Togliattit, nga masa e madhe e partisë”³². Ata kërkonin që t’i komunikohesh udhëheqjes së KQ të PPSH “indinjatën

³⁰ AMPJ / KMKMBJ, V. 1962/grupi C, D. 1960-1970. Letër e Gaetano Milaza, në emër të Federatës së të rinjve komunistë italianë, Circolo “Carl Marx” për KMKMBJ, Catania, 25 mars 1962.

³¹ *Po aty*.

³² AQSH, F. 14/AP, str., V. 1962, D. 562, fl. 26. Letër e Alberto Bucco për KQ të PPSH, 18 shtator 1962.

e thellë të të gjithë shokëve që mendojnë si ne, sa i takon sulmit të ashpër dhe të paargumentuar që tezat e PKI përmbajnë kundër partisë suaj”³³.

Sa i takon kërkesës për material propagandistik mbi Shqipërinë, të kërkuara nga të rinjtë e shoqatës “Karl Marks”, Misto Treska, kryetar i KMKMBJ e vë në dijeni legatën shqiptare në Romë mbi dërgimin e tij. Materiale shtesë do t’i dërgoheshin pas disa muajsh nga legata shqiptare në Paris, “me porosi që të mos verë asnjë shënim kush i dërgon”. Gjithashtu, ai e nxiti legatën shqiptare në Romë të mbajë kontakte me këta të rinj dhe t’u dërgojë herë pas herë materiale³⁴. Kjo ishte, si rregull, porosia që u jepej diplomatëve shqiptarë në Romë, me synimin për të zgjeruar rrethin e “miqve të Shqipërisë”.

Sa i takon letrës mbi të përjashtuarit e Padovës, çështja ishte më serioze dhe u diskutua në strukturat partiake në Tiranë. Në tetor 1962, Hysni Kapo i dërgon një letër të gjatë personale Jordan Panit, në të cilin i jep udhëzime të hollësishme se si duhet të sillet me grupet e reja marksiste-leniniste. Për Hysni Kapon situata ndërkombëtare ishte shumë e përshtatshme dhe favorizonte krijimin e një lëvizjeje komuniste me të vërtetë marksiste-leniniste. Ai flet gjatë e gjerë në letër mbi situatën mjaft “të nderë” në vendet socialiste të Evropës si: në Hungari, Bullgari, Çekosllovakia, Rumani dhe RD Gjermane, në të cilat “dështimet në sektorë të ndryshëm të ekonomisë po duken gjithnjë dhe më qartë”. Kjo, sipas sekretarit të KQ të PPSH i jepte mundësi që të luftohej revizionizmi me fakte dhe argumente të forta. Drejtuesit e PPSH-së vërenin se konfuzioni ideologjik dhe politik që tezat e “revizionistëve” kishin krijuar në kokën e njerëzve, po shkaktonin edhe reagimin e tyre. “I tillë na duket, shkruante Kapo, - botimi i gazetës “Viva il Leninismo” nga ana e disa komunistëve të Padovës, të cilët në mënyrë të hapur dënojnë oportunitetin e Togliattit. Edhe në Francë ka gjëra të tilla të ngjashme: një grup komunistësh qarkullojnë në parti një material kundër udhëheqjes oportuniste të PK të Francës³⁵”.

Hysni Kapo i jep Panit udhëzime të detajuara se si do të duhet të vijojë puna për të zgjeruar sa më shumë rrethin e miqve të Shqipërisë, duke përcaktuar një strategji me tri pika. Në radhë të parë, ai porosiste të

³³ *Po aty*.

³⁴ *AMPJ / KMKMBJ*, V. 1962, D. 1960-1970. KMKMBJ për legatën shqiptare në Romë, 18 gusht 1962.

³⁵ *AQSH*, F. 14/AP (str.), V. 1962, D. 558, fl. 2. Letër e Hysni Kapos për ministrin shqiptar në Romë, Jordan Pani, 30 tetor 1962.

vijonte puna për të shpërndarë sa më shumë materialet propagandistike të PPSH-së. Ai i kujton Jordan Panit dy artikujt e fundit të botuar te “Zëri i Popullit”: “Revizionizmi modern, ndihmës i strategjisë themelore të imperializmit amerikan” dhe “Tradhëti e madhe ndaj marksizëm-leninizmit”, të cilët duhet të shpërndaheshin sa më shumë në të gjithë Italinë. “Mundohuni të gjeni adresa të komunistëve në krahina të sekretarëve ose të komiteteve të partisë (si ta shikoni të arsyeshme ju), kudo që janë dhe u dërgoni atyre këto materiale si dhe materialet e mëparshme, pavarësisht se nuk njihemi me ta ose se nuk kanë kërkuar vetë. Nuk ka asnjë rëndësi në qoftë se ndonjëri duhet t’ua kthejë. Kuptohet se ju nuk do ta shkruani në zarfet se e dërgon Legata Shqiptare”³⁶. Shpërndarja e materialeve propagandistike nuk duhej të kufizohej vetëm në Itali, por legata shqiptare duhet t’ia dërgonte ato të gjitha kontakteve që kishte edhe në vende të tjera, “vendet arabe, të Amerikës Latine dhe për çdo vend tjetër”.

Së dyti, Hysni Kapo e porosiste Jordan Panin se si duhej të punonte me komunistët italianë. Ai e nxiste ministrin shqiptar të mbante kontakte të vazhdueshme me komunistët e Padovës “t’u dërgosh menjëherë materiale të PPSH, pa vënë emrin dhe pa thënë kush i dërgon, bile jo vetëm nga një kopje, por secilit nga një ose më shumë ekzemplarë. Për çdo gjë që do të marrish vesh rreth atyre, na njofto”³⁷. Sa i takon pjesës tjetër të komunistëve italianë, letra i ndan në disa kategori dhe, Hysni Kapo përcaktonte detyrën e ministrit për secilën nga kategoritë. Për komunistët të cilët tregoheshin miqësorë, por nuk përkrahnin tezat e PPSH-së, duhej të evitoheshin takimet e shumta. “Elementëve si ky u dërgoni kurdoherë materiale, në të rallë mund edhe të takoheni dhe të bisedoni me ta, por ruajuni se mund të jenë vënë rreth jush me qëllim”³⁸. Me komunistët të cilët ishin afër drejtuesve të PKI, apo punonin në aparatit e saj, por që nuk ishin treguar entuziastë për tezat e PPSH-së “më shumë blini, por mos u jepni gjë, përveç materialeve të partisë sonë, dhe ato vetëm kur ua kërkojnë”. Në këtë kategori letra fuste dhe sekretarin e Shoqatës së Miqësisë Itali-Shqipëri, Franco Portone. Hysni Kapo porosiste që puna të mos kufizohej “vetëm në ata që janë hequr më

³⁶ *Po aty*, fl. 4. Letër e Hysni Kapos për ministrin shqiptar në Romë, Jordan Pani, 30 tetor 1962.

³⁷ *Po aty*.

³⁸ *Po aty*, fl. 5. Letër e Hysni Kapos për ministrin shqiptar në Romë, Jordan Pani, 30 tetor 1962.

parë si miq të popullit tonë, por që tani mundohen t’ju largohen sa më shumë. Nuk është e domosdoshme të takohesh me D’Onofrion³⁹, për deri sa ju vini re se ai i largohet bisedës me juve”⁴⁰.

Së fundi, Hysni Kapo nxiste diplomatin shqiptar të ishte i përmbajtur. Çdo takim duhej përgatitur me kujdes dhe, në asnjë rast përfaqësuesit shqiptarë nuk duhej të zhvillonin takime të befasishme. Kishte disa arsye se përse Hysni Kapo e kërkonte këtë gjë. Qeveria shqiptare donte të shmangte ndonjë incident diplomatik siç ishte ai i Koço Kallços⁴¹, i cili e vuri në pozitë shumë të vështirë qeverinë shqiptare dhe mund të rrezikonte progresin delikat që kishte bërë ajo në marrëdhëniet tregtare me Italinë. Hysni Kapo i rikujton ministrit shqiptar: “Mbani gjithnjë parasysh të jeni punëtor partie, por njëkohësisht jeni dhe përfaqësues i RPSH dhe duhet të ruani pozitën tuaj”. Nga ana tjetër, drejtuesit komunistë donin të ruheshin nga provokimet. “Ashtu siç u porositi shoku Enver kur ishit këtu nuk duhet që me cilindo njeri, sa po të njiheni herën e parë të filloni të bëni agjitacion dhe propagandë, t’i flisni menjëherë për divergjencat midis nesh dhe revizionistëve modernë”⁴². H. Kapo porosiste diplomatët të kishin kujdes dhe të tregoheshin të kujdesshëm në marrëdhëniet me kontaktet që vendosnin. Të krijonin më

³⁹ Eugenio D’Onofrio ishte një nga drejtuesit e KQ të PKI dhe deputet në Parlamentin Italian. Gjatë Luftës së Dytë Botërore kishte qenë ushtar në Shqipëri. Pas kapitullimit të Italisë ishte bashkuar me rezistencën kundër pushtuesit gjerman dhe kishte qenë një nga partizanët e batalionit Antonio Gramsci. Pas luftës e kishte vizituar disa herë Shqipërinë dhe drejtuesit e lartë të PPSH e konsideronin si një prej miqve të Shqipërisë. Pas Kongresit VII të PKI, ai ndonëse nuk ishte dakord me tezat e Togliattit, nuk iu bashkua grupeve marksiste-leniniste dhe vijoi të ishte pjesë e PKI.

⁴⁰ AQSH, F. 14/AP (str.), V. 1962, D. 558, fl. 6. Letër e Hysni Kapos për ministrin shqiptar në Romë, Jordan Pani, 30 tetor 1962.

⁴¹ Koço Kallço ishte një nga punonjësit e legatës shqiptare i cili disa muaj më parë ishte larguar si *persona non gratta* nga Italia pasi dyshohej se ishte marrë me spiunazh, duke përvetësuar të dhëna sekrete ushtarake. Si kundërpërgjigje, qeveria shqiptare kërkoi largimin e Sekretarit I të legatës italiane në Tiranë. Çështja Kallço e vuri në një pozitë të vështirë përfaqësinë shqiptare në Romë, veçanërisht me detyrat që i ishin ngarkuar asaj nga KQ i PPSH. Shih: AQSH, F. 14/AP, str., V. 1962, D. 565, fl. 1-3. Relacion mbi takimin në Ministrinë e Jashtme të Italisë mbi çështjen e Koço Kallços, 13 janar 1962.

⁴² AQSH, F. 14/AP (str.), V. 1962, D. 558, fl. 4. Letër e Hysni Kapo për ministrin shqiptar në Romë, Jordan Pani, 30 tetor 1962.

parë marrëdhënie miqësore dhe besimi me ta dhe, më pas, t'i angazhonin në biseda me karakter politik⁴³.

Vitet 1961-1962 ishin dy vite intensive në përpjekjet e PPSH për të thyer izolimin që kishte shkaktuar konflikti me BRSS dhe për të gjetur mbështetje mes komunistëve italianë. Gjatë këtyre viteve, PPSH pati një farë suksesi për të evidentuar grupet dhe individët me të cilët do të punonte në të ardhmen. Në këtë proces, PPSH-në e ndihmoi situata e brendshme në PKI, strukturat e së cilës kishin pësuar një frakturë të fortë pas shpalljes së rrugës parlamentare për në socializëm. Komunistët e pakënaqur italianë i konsideronin kritikën e PKK ndaj Hrushovit, por edhe ndaj drejtuesve të tjerë të partive komuniste në Evropë, si një mundësi reale për të ruajtur të pastër ideologjinë marksiste-leniniste. Për ta, Partia e Punës së Shqipërisë nuk ishte gjë tjetër, veçse “Kina në pragun e shtëpisë”⁴⁴. Kjo nuk e pengoi Enver Hoxhën dhe drejtuesit e lartë të PPSH të përpiqeshin për të marrë pozicionin e liderit të lëvizjes marksiste-leniniste në Evropë. Suksesi në këto vite nuk ishte i dukshëm, pasi PPSH i mungonte mbështetja politike dhe financiare e Kinës, e cila ende ishte në përpjekje për të gjetur një zgjidhje diplomatike për konfliktin e saj me PK të BS. Situata ndryshoi në vitet në vijim, kur PKK u angazhua për t'i mbështetur financiarisht lëvizjet marksiste-leniniste në Botë dhe i dha mundësi PPSH të menaxhonte Fondin e Solidaritetit të krijuar për këtë arsye.

S u m m a r y

ALBANIAN LABOR'S PARTY LOOKING FOR "ALLIES" AMONGST ITALIAN COMMUNISTS (1961-1962)

During 1960-1961 the Communist Bloc was marked by the second important break. On December 3, 1961, Enver Hoxha and APL part way with the Soviet Union and experiencing what the Albanian writer Ismail Kadare would define as the "Winter of Great Loneliness". Leaders of APL tried to adapt as best as they could with the situation. In the domestic affair the state

⁴³ *Po aty*.

⁴⁴ N. Pedrazzi, *Italia che sognava Enver ...*, p. 342.

controlled media did not cease condemning the "Khrushchev's betrayal" and "heroic stance" held by Enver Hoxha and APL at the meeting of the 81 communist and workers parties in Moscow. In the APL's relationship with the international communist movement, Enver Hoxha's megalomania wanted to exploit the situation to give APL a leading role. This meant he hoped that enverism as a derivative of Marxism-Leninism would be a dominant ideology, at least for the Marxist-Leninist and communist movement in Europe.

The purpose of this article is to give an overview of the efforts of Enver Hoxha and the APL leaders to find supporters amongst Italian Communists in 1961-1962. The APL leaders used the controversies that were born within the PCI after Togliatti's thesis on the "Italian Road to Socialism". They struggled to convince those Italian Communists who did not believe in the Togliatti's thesis on "parliamentary actions as a way to seize the power". In this process, the Albanian diplomats in Rome played a primary role in propagating the "right path of the APL in the defense of Marxism-Leninism". During 1961-1962, APL had some success in identifying the groups and individuals with whom it would work in the future. For Enver Hoxha, finding allies within the ranks of the PCI meant securing a leading role in the international communist movement, but for displeased Italian Communists, the APL was nothing but "China at the doorstep".

